VENDIM
Nr. 72, datë 26.3.2018

MBI LICENCIMIN E SHOQËRISË "SMART WATT" SHPK NË AKTIVITETIN E TREGTIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE

Në mbështetje të neneve 16 dhe 37, germa "d", të ligjit nr. 43/2015 "Për sektorin e energjisë elektrike"; nenit 4, pika 1, germa "e"; nenit 5, pika 1, germa "e"; nenit 13 të rregullores "Për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike", miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 109, datë 29.6.2016; nenit 15 të rregullores "Për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s", miratuar me vendimin e Bordit nr. 96, datë 17.6.2016, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 26.3.2018, mbasi shqyrtoi relacionin për licencimin e shoqërisë "Smart Watt" sh.p.k., në aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike, përgatitur nga Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut,

konstatoi se:

- Shoqëria "Smart Watt" sh.p.k., me shkresën me nr. 137 prot., datë 31.1.2018, ka paraqitur kërkesën për t'u pajisur me licencë në aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike.
- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 50, datë 7.3.2018 vendosi: "Fillimin e procedurave për licencimin e shoqërisë "Smart Watt" sh.p.k. në aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike".
- Me shkresën nr. 55/10 prot., datë 9.3.2018 është bërë njoftimi në median e shkruar lidhur me fillimin e procedurave për licencim të shoqërisë "Smart Watt" sh.p.k.
- Aplikimi i shoqërisë "Smart Watt" sh.p.k., plotëson kërkesat e parashikuara nga ERE në rregulloren "Për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike", si më poshtë:
- Formati i aplikimit (neni 9, pika 1) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni financiar dhe fiskal (neni 9, pika 3) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni teknik për aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike (neni 9, pika 4/8, germat "a", "b", "c" dhe "d") është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Licencimin e shoqërisë "Smart Watt" sh.p.k. në aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike, për një afat 5-vjeçar.
2. Drejtoria e Licencimit dhe e Monitorimit të Tregut, të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga botimi në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit Ahmeti